



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:204909

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06004519

KPPP.nr.1277/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Sem - Pro” N.P.T., me NRB: 70430392, me seli në Prizren, rruga “Turgut Ozal”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Alija Ajro, avokat nga Prizreni, kundër debitorit “Bau - Metal” N.T.P., me NUI: 811296369, me seli në Viti, fshati Kllokot, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1380/2022, të datës 09.09.2022, të Përmbartuesit Privat Enis Hoxha, me seli në Prizren, jashtë seancës me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Bau-Metal” N.T.P., dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.1380/2022, i datës 09.09.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Sem-Pro” N.P.T. ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.1380/2022, të datës 09.09.2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.63 e datës 06.08.2018; Faturës Nr.64 të datës 06.08.2018; Faturës Nr.65 të datës 07.08.2018; Faturës Nr.66 të datës 07.08.2018; Faturës Nr.67 të datës 08.08.2018; Faturës Nr.08.08.2018; Faturës Nr.24 të datës 24.05.2018; Faturës Nr.25 të datës 24.05.2018; Faturës Nr.51 të datës 14.07.2018; Faturës Nr.19 të datës 17.05.2018; Faturës Nr.4 të datës 17.04.2018; Faturës Nr.20 të datës 17.05.2018; Faturës Nr.21 të datës 18.05.2018; Faturës Nr.188 të datës 20.02.2019; Faturës Nr.198 të datës 15.03.2019; Faturës Nr.204 të datës 20.03.2019; Faturës Nr.207 të datës 28.03.2019; Faturës Nr.215 të datës 05.04.2019; Faturës

Nr.161 të datës 13.12.2018; Faturës Nr.162 të datës 13.12.2018; Faturës Nr.163 të datës 14.12.2018; Faturës Nr.164 të datës 14.12.2018; Faturës Nr.178 të datës 04.02.2019; Faturës Nr.179 të datës 04.02.2019; Faturës Nr.180 të datës 05.02.2019; Faturës Nr.181 të datës 05.02.2019; Faturës Nr.182 të datës 06.02.2019; Faturës Nr.183 të datës 06.02.2019; Faturës Nr.117 të datës 01.10.2018; Faturës Nr.118 të datës 01.10.2018; Faturës Nr.119 të datës 02.10.2018; Faturës Nr.120 të datës 02.10.2018; Faturës Nr.121 të datës 03.10.2018; Faturës Nr.122 të datës 03.10.2018; Faturës Nr.123 të datës 04.10.2018; Faturës Nr.140 të datës 01.11.2018; Faturës Nr.141 të datës 01.11.2018; Faturës Nr.142 të datës 02.11.2018; Faturës Nr.143 të datës 02.11.2018; Faturës Nr.144 të datës 03.11.2018; Faturës Nr.145 të datës 03.11.2018; Faturës Nr.146 të datës 03.11.2018; Faturës Nr.97 të datës 14.09.2018; Faturës Nr.98 të datës 14.09.2018; Faturës Nr.99 të datës 15.09.2018; Faturës Nr.100 të datës 15.09.2018; Faturës Nr.101 të datës 15.09.2018; Faturës Nr.102 të datës 15.09.2018; Faturës Nr.269 të datës 13.06.2019; Faturës Nr.83 të datës 01.09.2018; Faturës Nr.84 të datës 01.09.2018; Faturës Nr.85 të datës 03.09.2018; Faturës Nr.86 të datës 03.09.2018; Faturës Nr.87 të datës 03.09.2018; Faturës Nr.88 të datës 04.09.2018; Faturës Nr.89 të datës 04.09.2018; Faturës Nr.90 të datës 04.09.2018; Faturës Nr.92 të datës 13.09.2018; Faturës Nr.93 të datës 13.09.2018; Faturës Nr.96 të datës 14.09.2018; Faturës Nr.230 të datës 23.04.2019; Faturës Nr.233 të datës 30.04.2019; Faturës Nr.237 të datës 08.05.2019; Faturës Nr.245 të datës 20.05.2019; Faturës Nr.256 të datës 28.05.2019; Faturës Nr.330 të datës 02.08.2019; Faturës Nr.331 të datës 03.08.2019; Faturës Nr.332 të datës 03.08.2019; Faturës Nr.336 të datës 14.08.2019; Faturës Nr.217 të datës 13.04.2019; Faturës Nr.328 të datës 01.08.2019; Faturës Nr.329 të datës 02.08.2019; Faturës Nr.312 të datës 18.07.2019; Faturës Nr.313 të datës 19.07.2019; Faturës Nr.322 të datës 24.07.2019; Faturës Nr.323 të datës 25.07.2019; Faturës Nr.327 të datës 01.08.2019; Faturës Nr.353 të datës 28.08.2019; Faturës Nr.355 të datës 05.09.2019; Faturës Nr.525 të datës 27.06.2020; Faturës Nr.526 të datës 29.06.2020; Faturës Nr.406 të datës 21.11.2019; Faturës Nr.407 të datës 21.11.2019; Faturës Nr.348 të datës 26.08.2019; Faturës Nr.349 të datës 26.08.2019; Faturës Nr.350 të datës 27.08.2019; Faturës Nr.351 të datës 27.08.2019; Faturës Nr.352 të datës 28.08.2019; Faturës Nr.497 të datës 16.06.2020; Faturës Nr.498 të datës 16.06.2020; Faturës Nr.503 të datës 18.06.2020; Faturës Nr.507 të datës 22.06.2020; Faturës Nr.509 të datës 22.06.2020; Faturës Nr.510 të datës 22.06.2020; Faturës Nr.511 të datës 23.06.2020; Faturës Nr.512 të datës 23.06.2020; Faturës Nr.513 të datës 23.06.2020; Faturës Nr.522 të datës 26.06.2020; Faturës Nr.523 të datës 26.06.2020; Faturës Nr.524 të datës 27.06.2020; Faturës Nr.541 të datës 11.07.2020; Faturës Nr.542 të datës 11.07.2020; Faturës Nr.543 të datës 11.07.2020; Faturës Nr.491 të datës 13.06.2020; Faturës Nr.492 të datës

13.06.2020; Faturës Nr.493 të datës 13.06.2020; Faturës Nr.494 të datës 15.05.2020; Faturës Nr.496 të datës 15.06.2020; Faturës Nr.540 të datës 10.07.2020; Faturës Nr.539 të datës 10.07.2020; Faturës Nr.538 të datës 10.07.2020; Faturës Nr.617 të datës 22.09.2020; Faturës Nr.648 të datës 13.11.2020; Faturës Nr.649 të datës 13.11.2020; Faturës Nr.651 të datës 13.11.2020; Faturës Nr.652 të datës 14.11.2020; Faturës Nr.653 të datës 14.11.2020 dhe Faturës Nr.654 të datës 14.11.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit sipas faturave t'ia paguaj kreditorit shumën prej 18,264.91 €, me kamatë ligjore 8% nga dita kur kërkesa është bërë e arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënimin të përbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme e te paluajtshme të debitorit deri në pagesën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar se kreditori ka përsëritur propozimin për të cilin është vendosur njëherë dhe kjo çështje është çështje e gjykuar, andaj i njëjti borxh nuk mund të kërkohej dy herë. Tutje ka shtuar se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar propozimi për përbarim janë paguar si fatura 51, 233, 230, 204, 207, 215, 525, 217, 188, 526, 523, 245, 256, 355, 522, 524, 183, 182, 181, 1801, 179, 178, dhe 336, duke bashkangjitur dëshmitë e pagesave, borxhi i kërkuar sipas faturave nga ana e kreditorit është i parashkruar pasi që të njëjtat janë të vitit 2018 dhe 2019. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të shfuqizohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, duke theksuar se pretendimet e debitorit se është përsëritur propozimi për përbarim nga kreditori nuk qëndron për faktin se kreditori tani kërkon detyrimin e tij të pa përmbushur nga debitori në shumë prej 18,264.91 €, e që ky detyrim rrjedh nga faturat të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përbarim, po ashtu nuk mund të konsiderohet çështje e gjykuar pasi që propozimi paraprak ka qenë për fatura të tjera. Tutje ka shtuar se pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin, nuk qëndrojnë pasi që parashkrimi është ndalur pasi që debitori pjesërisht e ka përmbushur detyrimin e tij, e po ashtu nuk ka arritur afati 3 vjeçar i parashkrimit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla, ndërsa sipas nenit 43 par.2 të LPP-së, përcaktohet se: *“Në aktvendimin për përmbartim dhe urdhrin për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm, duhet të tregohet dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit urdhërohet përmbartimi, kreditori dhe debitori, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përmbartimit...”*.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret kreditori sipas propozimi për përmbartim, ka kërkuar përmbushjen e borxhit nga e debitori në shumën e përgjithshme prej 18,264.91 €, mirëpo i njëjti nuk ka specifikuar se nga cilat fatura është kërkuar përmbushja e kësaj shume të detyrimit.

Gjykata gjeti se nga dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbartimor, përkatësisht nga faturat në bazë të së cilave kërkohet përmbushja e borxhit nuk përcaktohet qartë se cilat fatura kanë mbetur pa u paguar, cilat janë paguar pjesërisht dhe cilat janë paguar në tërësi, andaj si rrjedhojë këto dokumente nuk pasqyrojnë qartë detyrimet që rrjedhin nga të njëjtat.

Meqenëse në rastin konkret, kreditori nuk ka arritur që të specifikoj se për cilat fatura ka mbetur në detyrim debitori, cilat detyrime janë përmbushur nga ana e debitorit dhe për cilat

fatura kërkohet përmbushja e detyrimit në këtë procedurë përbarimore, rezulton se urdhri përbarimor është lejuar në kundërshtim me dispozitën e nenit 43 par. 2 të LPP-së, pasi që në rastin konkret nuk është përcaktuar se nga cili dokument i besueshëm rrjedh detyrimi për përmbushje nga ana e debitori me ç'rast të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk janë të përshtatshme për përbarim.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43, nenit 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1277/23, datë 31.07.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.